



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2024:032697

Datë: 20.06.2024

Numri i dokumentit: 05840527

2024:032698

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DIVIZIONI PENAL, si gjykatë e shkallës së parë penale e përbërë nga gjyqtarja e vetme gjykues Mimoza Shabani, me bashkëpunëtorin profesional Shkelzen Polloviqi në çështjen penale kundër të akuzuarit S.I me vendbanim në fshatin D.. Komuna Shtime, për shkak të veprës penale lajmërimi apo kallëzimi i rremë nga neni 382 par.1 të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj –Departamenti i Përgjithshëm e evidentuar si: PP.II.nr.1749/23 e datës 24 Janar 2024, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, në praninë e përfaqësuesit të akuzës - prokurorit të shtetit Ibadete Hamiti si dhe të akuzuarit, me datë 11 Qershor 2024 mori dhe publikisht komunikoi, kurse me datë 20 Qershor 2024, përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

S.I, i lindur me ... në fshatin D.. Komuna Shtime, nga i ati Sh... e ëma F... gjinisë N..., me vendbanim në rrugën “...” nr... në fshatin D.. Komuna Shtime, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, numër personal ...

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 15.04.2023, i pandehuri rreth orës 11:24, ka paraqitur lajmërim të rremë për një rast “Vjedhje” më saktësisht në shtëpinë e tij në fshatin D.. të Komunës së Shtimes, ka deklaruar që i janë vjedhur pajisje bujqësore si: një kositëse bari për traktor, si dhe një plug për lavrimin e tokës, vlera e dëmit të shkaktuar sillet rreth 1000€, te cilin rast i njejtë e ka paraqitur tek personat

zyrtar- policor, pas dhënjës së deklaratës i njëjti ka pranuar që nuk është kryer vjedhje por të njëjtat paisje i kishte shitur.

-me të cilin veprim ka kryer veprën penale lajmërim apo kallëzim i rremë nga neni 382 par.1 të KPRK-ës.

Andaj, Gjykata në bazë dispozitës së lartë shënuar si dhe neneve: 2, 17, 21, 38, 69, 70, 71, 72, 81 dhe 82 të KPRK-së, si dhe në bazë të neneve 365, 370, 453, 463 të KPP-ës, të akuzuarin S.I i shqipton,

V Ë R E J T J E G J Y Q Ë S O R E

Me të cilën të akuzuarit i bëhet me dije se ka kryer veprë të dëmshme dhe të rrezikshme që përbën veprë penale dhe nëse kryen prapë veprë të tillë, gjykata do ti shqiptoj sanksion më të rëndë penal.

Shpenzimet e procedurës gjyqësore bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Historiku procedurës dhe aktakuza

Gjykata Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm Penal, me gjyqtaren e vetme gjykuese në çështjen penale ndaj të akuzuarit S.I me vendbanim në fshatin D.. Komuna Shtime për shkak të veprës penale lajmërimi apo kallëzimi i rremë nga neni 382 par.1 të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm e evidentuar si: PP.II.nr.1749/2023 e datës 24 Janar 2024, duke vepruar në këtë çështje penale në bazë të nenit 242 par.5 të KPP-ës, ka mbajtur shqyrtimin fillestar me datë 11 Qershor 2024, në prezencën e prokurorit të shtetit si dhe të akuzuarit.

Gjyqtarja e vetme gjykuese pasi ka udhëzuar të akuzuarin në bazë të nenit 241 par.1 të KPP-ës dhe pasi prokurori i shtetit ka lexuar aktin akuzues dhe pasi gjyqtarja u bind se i njëjti e ka kuptuar aktakuzës, në bazë të nenit 241 par. 4 si dhe pas njoftimit sipas dispozitave të neneve

321 dhe 319 të KPPK-ës, të njëjtit i ofroj mundësinë të pranojë fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm.

Pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit

I akuzuari me rastin e deklarimit lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprën penale për të cilat është akuzuar, në shqyrtimin fillestar ka theksuar se e ndien veten fajtor dhe e pranon fajësinë sipas të gjitha pikave të aktakuzës, si dhe pranon fajësinë për veprimet e ndërmarra nga ana e tij, pranimin e ka bërë në mënyrë vullnetare duke qenë i vetëdijshëm për pasojat që mund të vijnë si rezultat i pranimit të fajësisë, duke shtuar se i vjen keq për këtë vepër penale, rastin e ka lajmëruar si vejdhje për tu arsyetuar te familja e tij, është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin.

Pasi që i akuzuari e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, gjyqtarja e vetme gjykuese duke vepruar në pajtim me nenin 242 të KPPK-së, ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit.

Prokurori i shtetit, me rastin e paraqitjes së mendimit lidhur me pranimin e fajësisë nga akuzuarit ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e akuzuarit, pasi pranimi fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe në përputhje me dispozitat ligjore të nenit 241 të KPRK-së si dhe provat materiale dhe faktet e çështjes, prandaj i propozoi gjykatës që të njëjtën ta shpallë fajtor dhe ta dënoj konform ligjit duke pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese ashtu që me sanksionin e shqiptuar të arrihet qëllimi i dënimit.

Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes kushtet e parapara nga neni 242 par. 2 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret si dhe materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe në provat tjera të cilat gjinden në shkresën e lëndës siç janë: raporti i oficerit 15.04.2023 të zyrtarit policor A.Xh me ID#9..., deklarata e dhëna të pandehurit të dhënë në hetuesi me datën 15.04.2023 si dhe me datën 26.10.2023, fotografitë dhe shkresat e tjera në lëndë.

Me qenë se i akuzuari e ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjyqtarja në bazë të nenit 242 paragrafit 6 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e

nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjykata po ashtu vërtetoi se prokurori ka disponuar me prova të mjaftueshme për veprën penale të të akuzuarit dhe ka dhënë mendimin për pranimin e fajësisë nga ana e tij.

Gjykata vërtetoi përtej çdo dyshimi se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-ës, meqë me datë, vend dhe kohë siç është përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi, i pandehuri ka deklaruar që i janë vjedhur pajisje bujqësore si: një kositëse bari për traktor, si dhe një plug për lavrimin e tokës, vlera e dëmit të shkaktuar sillet rreth 1000€, te cilin rast i njëjti e ka paraqitur tek personat zyrtar- policor, pas dhënjës së deklaratës i njëjti ka pranuar që nuk është kryer vjedhje por të njëjtat pajisje i kishte shitur.

Caktimi i dënimit për të akuzuarin

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoi rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-ës, si rrethanë veçanërisht lehtësuese vlerësoi pranimin e fajësisë për veprën penale të kryer, e cila është bërë në seancën e shqyrtimit fillestar, hera e parë që bie ndesh me ligjin kurse në rastin konkret si rrethanë rënduese gjeti faktin se vepra penale është kryer me dashje, ndërsa me rastin e vlerësimit të rrethanave rënduese gjykata vlerësoi intensitetin e rrezikimit apo i dëmtimit të së mirës së mbrojtur.

Mbi bazën e këtyre rrethanave, gjykata është e bindur se dënimi i shqiptuar është në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të akuzuarit, duke marrë parasysh edhe faktin se i njëjti ka bërë pranimin e fajësisë, është hera e parë që bie ndesh me ligjin, duke vlerësuar se edhe me sanksion të posaçëm penal si vërejtja gjyqësore, me anë të së cilit kryesit i jepet qortim dhe i bëhet me dije se ka kryer vepër të dëmshme dhe të rrezikshme, andaj shqiptimi i saj është i mjaftueshëm për të arritur qëllimin e dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-ës përkatësisht vërejtja e shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Shpenzimet procedurale

Vendimi mbi shpenzimet procedurës gjyqësore është marr në kuptim të dispozitës së nenit 452 par. 4 të KPP-ës, gjykata ka liruar në tërësi të akuzuarin nga shpenzimet e procedurës, duke marrë parasysh gjendjen e tij financiare, andaj ngarkesa me shpenzime do ta rrezikonte gjendjen materiale të të akuzuarit apo personave që i mban materialisht.

Në bazë të të lartecekurave u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

**Departamenti Përgjithshëm Penal,
2024:032698 i datës 20 Qershor 2024**

Bashkëpunëtori profesional,
Shkelzen Polloviqi

Gjyqtarja,
Mimoza SHABANI

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej pesëmbëdhjetë (30) ditëve, nga dita e parë e ardhshme pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj, për Gjykatën e Apelit të Kosovës.